



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. ____ /2025

Dt. 02/07/2025

PROCESVERBAL

Mbledhja e II-të e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb) në Komunën e Deçanit.

Mbledhja u mbajt me dt. 01.07.2025 ne ora 13:00

Rend dite :

1. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit;
2. Koordinimi ndërinstytucional për pritjen e bashkatdhetarëve në komunën e Deçanit
3. Të ndryshme

U mbajt mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb) në Deçan Sot në Komunën e Deçanit u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb), e cila u hap nga Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj.

Në fjalën hyrëse, kryetari Ramosaj vlerësoi se siguria në komunë është e kënaqshme dhe brenda suazave normale, duke theksuar rëndësinë e stabilitetit të përgjithshëm në bashkësi. Ai ngriti disa shqetësime të qytetarëve që prekin jetën e përditshme, si:

Ngasja me shpejtësi të lartë në komunikacion

Problemi i qenve endacakë

Mungesa e ujit të pijshëm gjatë sezonit veror, ku theksoi se ka pasur ankesa nga qytetarët.

Kryetari Ramosaj sqaroi se menaxhimi i ujit të pijshëm është përgjegjësi e kompanisë Hidrodrini.

Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës raportoi se situata e përgjithshme e sigurisë është e mirë, megjithatë rastet e dhunës në familje mbeten shqetësuese dhe kërkojnë përkushtim të shtuar institucional.

Drejtori për Shërbime Publike, z. Izet Zenuni, theksoi se nuk është e mundur të ketë praninë e policisë në çdo rrugë, por përparësi u jepet zonave përreth shkollave dhe institucioneve publike.

Komuna e Deçanit përmes KKSBS-së mbetet e përkushtuar në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët dhe institucionet relevante.



REPUBLICA
KOMUNA E
Kryetar
Municipality
Mayor
DEÇAN
Processmbajtëse:
Edone Kameran
[Signature]